



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 240/2 prot.

Tiranë, më 30.06.2020

VENDIM

Nr.47, datë 30.06.2020

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 147, DATË 21.11.2019,
NË INSTITUCIONIN BASHKIA BULQIZË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraparak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 147, datë 21.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Bulqizë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”*,

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, *“Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”*, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku u përfshi dhe Bashkia Bulqizë.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Bulqizë, vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 147, datë 21.11.2019, duke i

lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës, si dhe një afat prej 3 (tre) muajsh për zbatimin e tyre.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Bashkia Bulqizë, me shkresën nr.907 prot., datë 24.2.2020, "*Kthim përgjigje*", dhe përmes komunikimit në rrugë elektronike me e-mail në datën 16 qershor 2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Bulqizë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht:

1. Institucioni ka marrë masa dhe ka rikthyer gjendjen e ligjshmërisë për 10 rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, më konkretisht për: *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, duke u vendosur ndërprerja e marrëdhënies së punës.
2. Njësia përgjegjëse ka realizuar procedurën për ngritjen në detyrë në përputhje me nenin 26 të ligjit, dhe me aktin nr. 3141/10 prot., datë 08.10.2019, nëpunësja ***** është emëruar "*Drejtor*" në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Për shkak të ristrukturimit të kësaj bashkie kjo nëpunëse është transferuar në pozicionin "*Përgjegjës*" pranë kësaj drejtorie.
3. Janë hartuar përshkrimet e punës, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara.
4. Me urdhrin nr. 4199, datë 02.10.2019, Bashkia Bulqizë ka shpallur vendet e lira në administratën e saj.
5. Bashkia Bulqizë funksionon në përputhje me strukturën e miratuar me Vendimi nr.117, datë 10.1.2020 dhe në zbatim të detyrave të lëna është evituar përdorimi i emërtesës "*Specialist*", për pozicionet e punës të cilat nuk përfshihen në skemën e shërbimit civil.
6. Institucioni i mbikëqyrur, me Vendimin nr. 586 prot., datë 10.02.2020, ka miratuar planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin 2020.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 147, datë 21.11.2019, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Bulqizë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Bulqizë.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Bulqizë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha